

**Fisnik Kurshumliu***Kryeredaktor i Revistës Mjeku*

Sëmundjet reumatike përfshijnë një spektër të gjerë të patologjive që përfshijnë kockat, nyjat, muskujt dhe organet tjera.

Këto sëmundje kanë ndikim të rëndësishëm në kualitetin e jetës meqë kufizojnë lëvizshmërinë e individit dhe gjendjen e përgjithshme. Deri sa disa nga këto sëmundje mund të menaxhohen me terapi medikamentoze, ka prej tyre që shkaktojnë dëmtime të mëdha organike dhe rrezikojnë jetën.

Ky numër i revistës Mjeku, me temë bosht “Sëmundjet Reumatike” ka synim që të informojë lexuesin për faktorët e rrezikut, simptomat dhe opcionet terapeutike të këtyre sëmundjeve.

Me rritjen e shkallës së informacionit dhe të kuptuarit e këtyre problemeve shëndetësore, mund të përmirësohet kujdesi dhe mbështetja e pacientëve të përfshirë me sëmundje reumatike.

